

Numri i lëndës: 2022:163434
Datë: 23.01.2024
Numri i dokumentit: 05229572

P.nr.380/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – dega V., Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjyqese Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani në çështjen penale ndaj të pandehurit E.I. nga fshati S., Komuna e V. për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1261/2022, të datës 09.08.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe jo publik të datës 17.01.2024, me datë 19.01.2024, në mungesë të palëve mori dhe shpalli publikisht, kurse me datë 23.01.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **E.I.**, nga babai Aqif, nëna Vaxhide, e lindur Bislimi, i lindur me datë 12.02.1987 në Gjilan, me vendbanim në fshatin G., Komuna V., me vendqëndrim në shtetin e Gjermanisë, me adresë 48531Nordhorn Am Braskamp 24, i pa martuar, baba i një (1) fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, punon në shtetin e Gjermanisë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal 1174594402, lëshuar nga MPB-Prishtinë, Republika e Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, nga data 01.07.2020, në kohë të papërcaktuar në fshatin S. Komuna V., i pandehuri nuk i është bindur vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, në atë mënyrë që pas ndarjes, fëmiju i përbashkët i është besuar në përkujdesje të dëmtuarës, ish gruas të të pandehurit F.S., me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, dega në V., Divizioni Civil C.nr.645/2019, të datës 23.06.2020, i pandehuri është i obliguar që të paguaj alimentacion për fëmijun, në shumë prej 130.00 (njëqind e tridhjetë euro) në muaj, mirëpo i pandehuri deri më sot nuk e ka përmbushur detyrimin e tij, ashtu siç ka qenë i obliguar me vendim të gjykatës.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 7, 17, 38, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 242 dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin E.I.:

E G J Y K O N

Të pandehurit E.I.për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 500.00 € (pesëqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 € (njëzetë euro) të dënimit me gjobë.

Udhëzohet e dëmtuara F.S. nga fshati Komogllavë Komuna Ferizaj që kërkesën pasurore juridike (alimentacionin) ta vazhdoj në procedurën përmbartimore të filluar, me aktvendimin CP.nr. 93/2020, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjiilan, dega në V. është lejuar përmbartimi i aktgjykimit C.nr.645/2019, i datës 23.06.2020.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € dhe shumën prej 20.00 € për viktimat e krimit konform nenit 39 par. 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 10.08.2022, në Gjykatën Themelore në Gjiilan, Dega në V. ka dorëzuar aktakuzën PP.II.nr.1261/2023, të datës 09.08.2022, ndaj të pandehurit Z.L.nga fshati S., Komuna e V. për shkak të veprës E.I., nga fshati S., Komuna e V. për shkak të veprës penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës nga neni 245 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Me datë 06.06.2023, është caktuar seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit K.F.dhe e dëmtuara F.S., kurse ka munguar i pandehuri E.I. Në seancën e njëjtë prokurorja e shtetit ka bërë përmbartimin e dispozitivit të aktakuzës duke deklaruar se në vend të fjalisë “i është shmangur sigurimit të mjeteve të jetesës, për personin për të cilin është i detyruar të kujdeset, duhet të jetë “i pandehuri nuk i është bindur vendimit të plotfuqishëm të gjykatës”, si dhe ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës nga neni 245 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në veprën penale mos përfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me datë 18.01.2024, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe jo publik, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit L.K., e dëmtuara F.S. dhe i pandehuri E.I., pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë ndaj të pandehurit E.I.për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza edhe atë: raporti fillestar i incidentit me nr. 2021-CG-390, i datës 01.07.2020, deklarata e të dëmtuarës F.S., deklarata e dëshmitares M.S., deklarata e të pandehurit E.I., dëshmi lidhur me pagesat e kryera, procesverbali nga shqyrtimi kryesor C.nr. 645/2019, i datës 23.06.2020, aktgjykimi i datës 26.06.2020, parashtrësia e datës 30.06.2021, ankesa drejtuar PS në Ferizaj e datës 13.08.2020, padia për shkurorëzim e datës 13.12.2019, njoftimi i datës 16.06.2021 me të cilin është lejuar përmbartimi i aktgjykimit C.nr. 645/2019, i datës 23.06.2020, vërtetim mbi llogarinë bankare, fletë deponimi i datës 05.07.2022, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara, raporti i policës hetuese Ibadete Sylejmani, si dhe shkresat e tjera në lëndë dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri E.I., ka kryer veprën penale: mospërfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqyrtimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 500.00 € (pesëqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka premtuar që nuk do të përsëris këto veprime, është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, ndërsa si rrethanë rëndësuese gjykata mori parasysh se kjo vepër penale është kryer me dashje, duke mos e përfillë aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, dega në V., Divizioni Civil C.nr.645/2019, të datës 23.06.2020, andaj edhe mbi të lartcekurat gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur, duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

5. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të të pandehurit duke i marr parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

6. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike

E dëmtuara F.S. nga fshati Komogllavë Komuna Ferizaj është udhëzuar që kërkesën pasurore juridike (alimentacionin) ta vazhdoj në procedurën përmbartimore të filluar, me aktvendimin CP.nr. 93/2020, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan, dega në V., me të cilin është lejuar përmbartimi i aktgjykimit C.nr.645/2019, i datës 23.06.2020 dhe gjykata konsideron si çështje të gjykuar.

7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 449 të KPP-së, ka vendos që të pandehurin ta obligojë në pagimin e shpenzimeve të procedurës: paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € dhe shumën prej 20.00 € për viktimat e krimin konform nenit 39 par. 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata konform nenit 364 par. 1 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – dega V.

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.380/2022, me datë 23.01.2024

**Gjyqtarja e vetme gjyquese,
Blerina Jakupi Ramadani**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.